



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1226

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi-Anëtar të Panelit duke vendosur sipas ankesës së OE "Mobelland" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ri - tender” me numër të prokurimit 616-24-8683-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, më 07.02.2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet pjesërisht e bazuar ankesa e "Mobelland" SH.P.K. me nr. 2024/1226, e datës 16.12.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ri - tender”, me numër të prokurimit 616-24-8683-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.
2. Vërtetohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ri - tender”, me numër të prokurimit 616-24-8683-1-1-1.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.08.2024 KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ri - tender" me numër të prokurimit 616-24-8683-1-1-1.

Me 04.12.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin ka shpërblyer me kontratë OE Made Kos sh.p.k & Woodcorporation L.L.C.

Me 09.12.2024, OE "Mobelland" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e cila është refuzuar si e pa bazuar me Vendimin e AK të datës 17.12.2024.

Me 17.12.2024, OE "Mobelland" SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2024/1226, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e Operatorit Ekonomik "Mobelland" SH.P.K., lidhur me ankesën 1226/2024:

Të nderuar, sikurse jeni në dijeni, ne kemi konkurruar në tenderin me titull: Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së, Ritender me nr. të Prokurimit: 616-24-8683-1-1-1 dhe nr. të brendshëm: 616-24-140-1-1-1, të shpallur më datë 22.08.2024. Afati i fundit për dorëzimin e tenderit ka qenë më datë 11.11.2024 deri në orën 14:00. Hapja e tenderit është bërë me datën e njëjtë duke filluar në orën 14:00. Njoftimin si tenderues i eliminuar e kemi marrë në vendimin e AK-së B58 të publikuar më datë 04.12.2024, ora 16:08. Kriteri për dhënien e kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Më datë 09.12.2024, brenda afatit kohor, kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim. Autoriteti Kontraktues nuk e ka pezulluar procedurën në Ijalë, as nuk na ka kthyer përgjigje dhe nuk ka marrë vendim për rishqyrtim të kërkesës tonë brenda tri (3) ditëve të punës, sikurse parashihet me Rregulloren e Prokurimit 001/2022.

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjitni një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-

së.

Autoriteti Kontraktues, Zyra e Prokurimit e Komunës së Prishtinës, më datë 04.12.2024 ka publikuar dokumentin B58, me të cilin ka vendosur që të shpërblejë me kontratë Grupin e Operatorëve Ekonomikë "Wood Corporation" SH.P.K dhe Madekos SH.P.K, kurse ne, me letrën standarde, na ka cilësuar si tenderues të papërgjegjshëm për tenderin në fjalë.

Të pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpërblimin me kontratë të një O.E. të papërgjegjshëm dhe me çmim më të lartë se oferta jonë, si dhe me vlerësimin jo të drejtë të tenderit në fjalë, duke u bazuar në nenin 10 të LPP-së, kemi kërkuar qasje në dokumentacionin tenderik. Me këtë rast, AK na ka dhënë qasje në dokumentet e kërkuara, nga të cilat kemi vërejtur se O.E. i propozuar për kontratë ka dorëzuar tender të papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në nenin 108A të LPP-së, kemi dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim të vendimit të AK-së, në të cilin kemi cekur se me rastin e vendimit, Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të LPP-së të rregulluara me Nenin 1; 6; 7; 27; 52; 56; 59; 60 dhe 72 të LPP-së, si dhe Nenin 4; 26; 39.11; 40; 45.19; 45.20 dhe 45.22 të Rregullorës nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Lidhur me pretendimet ankimore nr. 1, 2, 4, 5 dhe 6, është gjetur se të gjitha arsyet eliminuese të konstatuara nga komisioni vlerësues janë të sakta në tërësi. Rrjedhimisht, pretendimet ankimore në këto pika janë të pabazuara.

Më konkretisht, lidhur me pretendimin nr. 1, është gjetur se arsyeja eliminuese i referohet kërkesës së DT të formuluar si vijon: "Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit...". Pra, në DT është kërkuar shprehimisht që të plotësohet aneksi 6 i DT. Në rastin konkret, nuk është kontestuese as për parashtruesin që asnjëri nga anëtarët e GOE nuk e kanë plotësuar këtë aneks të dosjes së tenderit. Prandaj, arsyeja eliminuese është e saktë, ndërsa pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 2, është gjetur se arsyeja eliminuese i referohet kërkesës së DT të formuluar si vijon: "2. Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional, të cilët duhet të kenë kualifikimet shkollore të mëposhtme: a) Një dizajner të interiorit, b) Një arkitekt të brendshëm dhe dizajn për ambiente, të gjitha me minimum 4 vite përvojë pune; 2. Të dëshmojnë me CV, Diplomë universitare të noterizuara, kontratë pune për stafin."

GOE ka prezantuar z. Fahri Beqiri si dizajner të interiorit dhe znj. Florijeta Beqiri si arkitekt të brendshëm dhe dizajn. Fillimisht, duhet cekur se në DT është kërkuar shprehimisht kontratë e punës për stafin e kërkuar. Nga ana tjetër, parashtruesi ka dorëzuar parakontrata. Nuk qëndron argumenti i parashtruesit, sipas të cilit parakontrata është përpiluar në përputhje me nenin 33 të LMD, pasi që në rastin konkret nuk është kërkuar kontratë detyrimore në kuptim të LMD, por kontratë pune në kuptim të ligjit të punës. Mbi të gjitha, për znj. Florijeta Beqiri janë kërkuar së paku 4 vite përvojë të punës profesionale. Mirëpo, e njëjta ka dorëzuar diplomën e studimeve themelore, ku evidentohet se e njëjta ka diplomuar më datë 14 dhjetor 2020, që nënkupton se nuk ka pasur mundësi të krijojë 4 vite të përvojës së punës profesionale, përderisa hapja është bërë në nëntor të vitit 2024, pra ende pa u mbushur 4 vite kalendarike. Absolutisht nuk qëndron argumenti i parashtruesit, ku thuhet se duhet të merret parasysh data e përfundimit të studimeve dhe jo data e diplomimit. Kjo për arsye se studimet mund të përfundojnë në një datë të caktuar,

mirëpo titulli përkatës akademik fitohet ekskluzivisht në momentin e diplomimit. Prandaj, konstatimi i komisionit vlerësues dhe arsyeja eliminuese janë të sakta, ndërsa pretendimi ankimor i parashtruesit është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 4, është gjetur se arsyeja eliminuese i referohet kërkesës së DT të formuluar si vijon: "4. OE të posedojë mjete, stabilmente, dhe pajisjet makinerike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit (2 automjete pikup të regjistruara), (2 kamionë 3.5 ton të regjistruar). 4. Librezat për autopikap, kamion të ofrohen, për makinat të ofrohen DUD-at (në rast kur OE ka marrëveshje për shfrytëzim të autopikapave dhe kamionit, të ofrohen marrëveshjet e noterizuara me të dhënat e aktivitetit të këtij prokurimi)."

Në rastin konkret, parashtruesi ka dorëzuar një marrëveshje për marrjen e qirasë së automjeteve me qiradhënësin, mirëpo kjo marrëveshje nuk është e noterizuar. Parashtruesi ka dorëzuar një autorizim (jo deklaratë noteriale për noterizim të marrëveshjes së qirasë), mirëpo autorizimi, i cili është i datës 27.10.2023, nuk i referohet fare as marrëveshjes për qira dhe as aktivitetit të prokurimit për të cilin po bëhet fjalë. Prandaj, arsyeja eliminuese është e saktë, ndërsa pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 5, është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar vlerësimin e riskut pa afat (më të vjetër se 2 vite), dhe ky fakt nuk kontestohet nga parashtruesi. Prandaj, arsyeja eliminuese është e saktë, ndërsa pretendimi ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 6, është gjetur se arsyeja eliminuese i referohet kërkesës së DT të formuluar si vijon: "6. Autorizimi i prodhuesit ose dilerit të autorizuar dhe Katalogu Broshura e prodhuesit për Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 (për këto pozita lejohet ofertimi me dimensione +-5%)"

Në kërkesën për rishqyrtim, parashtruesi pretendon se është vetë prodhues i pajisjeve mjekësore medicinale. Prandaj, ai ka dorëzuar një katalog të vulosur dhe nënshkruar nga vetë parashtruesi. Nga ana tjetër, nga çertifikata e biznesit të parashtruesit, rezulton se aktiviteti primar dhe sekondar i parashtruesit është prodhimi i mobilieve të kuzhinës dhe mobilieve të tjera, megjithëse një nga kodet e veprimtarisë është edhe prodhimi i instrumenteve dhe pajisjeve mjekësore dhe dentare në mes 22 aktiviteteve të përgjithshme të parashtruesit. Nga ky këndvështrim, mund të thuhet se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar. Megjithatë, duke marrë parasysh të gjeturat lidhur me arsyet e tjera eliminuese dhe faktin që oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme, ky konstatim nuk mund të ndikojë në epilogun e këtij vendimi.

Lidhur me pretendimin nr. 3, është gjetur se kërkesa për ISO të cilës i referohet arsyeja eliminuese është formuluar në DT si kërkesë për kapacitetin teknik dhe profesional. Në anën tjetër, nuk është kontestues fakti që së paku njëri anëtar i GOE i ka dorëzuar çertifikatat ISO të kërkuara me DT. Në kuptim të nenit 26.5 të RRPP, kjo kërkesë e DT duhet konsideruar si e përmbushur. Rrjedhimisht, arsyeja eliminuese është e pasaktë, ndërsa pretendimi ankimor është i bazuar. Megjithatë, duke marrë parasysh të gjeturat lidhur me arsyet e tjera eliminuese dhe faktin që oferta e parashtruesit është e papërgjegjshme, as ky konstatim nuk mund të ndikojë në epilogun e këtij vendimi.

Lidhur me pretendimin nr. 7: të drejtuar kundër tenderuesit tjetër në këtë aktivitet të prokurimit, duhet sqaruar se parashtruesi, përderisa vet ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të dëshmojë asnjë interes material nga cilido rezultat i aktivitetit të prokurimit në raport me këto pretendime të tij ankimore të drejtuara kundër tenderuesve të tjerë. Përmes nenit 4, par. 1,

nënpar. 26 të LPP përcaktohet se "Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi, duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar". Nga këndvështrimi i kësaj dispozite të LPP, përderisa parashtruesi për vete ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, dhe nuk ka arritur të dëshmojë të kundërtën as me këtë kërkesë për rishqyrtim, atëherë i njëjti nuk është palë e interesuar në raport me pretendimet e tij ankimore kundër tenderuesve të tjerë. Megjithatë, duhet cekur se tenderuesi i rekomanduar për kontratë, sipas vlerësimit të komisionit vlerësues, ka dorëzuar ofertë tërësisht të përgjegjshme. Prandaj, rekomandimi për dhënie të kontratës nga komisioni vlerësues është në përputhje të plotë me kriteret e dhënies së kontratës sipas dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera, edhe po të ishte palë e interesuar parashtruesi në raport me këto pretendime, sërish pretendimet e tij janë të pabazuara.

Sa i përket pikës së pretendimit nr. 7 lidhur me çertifikatat ISO të tenderuesit të rekomanduar, duhet cekur se anëtari i GOE ka dorëzuar çertifikatat me validitet dhe të njëjtat janë të mjaftueshme për të konsideruar si të përmbushur kërkesën e DT. Kërkesa për ISO është formuluar në DT si kërkesë për kapacitetin teknik dhe profesional. Prandaj, në kuptim të nenit 26.5 të RRPP, kjo kërkesë e DT duhet konsideruar si e përmbushur nëse njëri anëtar i GOE i dorëzon dëshmitë e kërkuara dokumentare. Rrjedhimisht, kjo pikë e pretendimit ankimor është e pabazuar.

Sa i përket pikës së pretendimit nr. 7 se pajisjet sipas katalogut dhe autorizimit të tenderuesit të rekomanduar nuk janë në përputhje me paramasën, as kjo pikë e pretendimit ankimor nuk qëndron, pasi që në katalogun e dorëzuar evidentohen të gjitha specifikat teknike në pozitat përkatëse, sikurse janë kërkuar me DT.

Në këtë mënyrë, është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, ndërsa të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara, me përjashtim vetëm të pretendimit nr. 3 që është gjetur si e bazuar dhe pretendimit nr. 6 që është gjetur si pjesërisht e bazuar. Prandaj, kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63, par. 63.1.1, nënparagrafin b) lidhur me nenin 62, par. 62.1, nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63, par. 63.2 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 24.12.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2024/1226, ndërsa me datë 31.12.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1226, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr

parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Mobelland" SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1226, ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e madhe, lloji i kontratës furniyim, vlera e parashikuar 600,000.00€.

AK me dt. 22.08.2024 ka publikuar Njoftimin për kontratë ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 11.11.2024 dhe për këtë aktivitet prokurimi kishin aplikuar dy operator ekonomik në mesin e tyre edhe OE ankues

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me dt. 04.12.2024 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku për kontratë ka rekomanduar grupin e OE Made Kos sh.p.k & Woodcorporation L.L.C vlera e ofertës me poentim 3,217.30€. Ndërsa ofertën e OE ankues komisioni i vlerësimit e ka vlerësuar si ofertë të pa përgjegjshme/eliminuar.

Kundër njoftimit mbi vendimin e AK, pala fillimisht parashtron kërkesë për Rishqyrtim tek AK me dt. 09.12.2024 brenda afatit ligjor. AK me dt.17.12.2024 nxjerr vendim mbi refuzimin e kërkesës si të pa-bazuar, vlenë të ceket fakti se AK, e ka arsyetur vendimin e saj lidhur me secilin pretendim ankimore të OE ankues. OE i pakënaqur me vendimin e AK-së me dt. 16.12.2024 paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me pretendime të njëjta.

Përgjigje në Pretendimet e OE ANKUES

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se pikënisja e problemit ka të bëjë me atë se OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme dhe ka ofertuar me çmimin me të lartë se sa oferta e OE ankues të cilën komisioni për vlerësimin e ofertave e ka eliminuar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-se për faktin se ne kemi dorëzuar ofertë të përgjegjshme.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmime të dokumentuara në platformën elektronike E-prokurimi, AK në dosjes së tenderit tek kapaciteti teknik dhe profesional apo 9&1 dhe 9&2 saktësisht kërkesat me numer rëndor 1,2,3,4,5,dhe 6 si në vijim;

Kërkesa e dosjes së tenderit Kërkesa 1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme për furnizime në vlerë minimale në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë) 900.000,00 €

Dëshmia; Evidenca 1. Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës të bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve.(në rast se furnizimi është kryer tek bleseri privat duhet të deshmohet referenca, raporti i pranimit, fatura dhe transaksioni i bankës)

Kërkesa e dosjes së tenderit numer 2; Operatori ekonomik duhet të angazhojë personelin profesional të cilet duhet të ketë kualifikimet shkollore të mëposhtme a) Një dizajner të interiorit, b) Një arkitekt i brendshëm dhe dizajn për ambiente të gjitha me minimum 4 vite përvojë pune)

Dëshmia për kërkesën 2; Të deshmohen me CV, Diplome universitare të noterizuara, kontrate të punës për stafin.

Kërkesa e dosjes së tenderit numer 3. Operatori ekonomik të ofrojë Certifikatat ISO 9001 2015 dhe 13485 2016 të noterizuara.

Dëshmia për kërkesën 3, Kopja e certifikatës së noterizuara valide.

Kërkesa e dosjes së tenderit numer 4, OE të posedojë mjete, staibilmente, dhe pajisjet makinerike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit (2 automjete pikup të regjistruara), (2 kamion 3.5 Ton të regjistruara).

Dëshmia për kërkesën 4, Librezat për autopikap, kamion të ofrohen, për maqinat të ofrohen DUD-at (në rast kur OE ka marrëveshje për shfrytëzim të autopikapave dhe kamionit të ofrohen marrëveshjet e noterizimeve me të dhenat e aktivitetit të këtij prokurimit).

Kërkesa e dosjes së tenderit numer 5, Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se ka kryer vlersimin e riskut për të gjitha pozitat konform ligjit 04 L-161.ligjit 04 L-161.

Dëshmia për kërkesën 5, Operatori Ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka kryer vlersimin e riskut për të gjitha pozitat konform ligjit 04 L-161.ligjit 04 L-161.

Kërkesa e dosjes së tenderit numer 6, Autorizimi i prodhuesit ose dilerit të autorizuar dhe Katallogu Broshura e prodhuesit për Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 (për këto pozicione lejohet ofertimi me dimensione +-5%).

Dëshmia për kërkesën 6, Kopja e Autorizimit me të dhenat e tenderit, Kopja e Katallogut Broshurave e prodhuesit për Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 (për këto pozicione lejohet ofertimi me dimensione +-5%)

Pas shqyrtimit të provave shkresore vlerësojmë se dokumentat e kontestuara nga OE ankues – sa i përket listës së kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, OE ankues për ta përmbushur këtë kërkesë me ofertë ka dorëzuar filen e emërtuar “ Lista e kontratave të realizuara-Mobelland”, në nën file 3 kishte bashkëngjitur listën e kontratave të realizuara nga anëtarë i konzerciumit Interlab, vlenë të ceket se përveç që nuk ishte plotësuar aneksi 6 i dosjes së tenderit siç ishte kërkuar në kërkesën e dosjes së tenderit, poashtu lista e dorëzuar nuk e përmbushte as kërkesën e dosjes sa i përket vitete të realizuara për faktin se të gjitha projektet e prezantuara në listë i

takonin periudhës 2017 dhe në fund të listës ishte paraqitur vlera e kontratave në vlerë prej 288,299.49€ si shumë totale e kontratave të nënshkruara për vitin 2017.

Në të njëjtin file, OE ankues kishte bashkangjitur edhe një listë tjetër në emër të OE Mobelland shpk, me gjithësej 21 projekte të realizuara ndër vite me vlerë prej 3,896,258.00€, vlenë të ceket fakti se lista e kontratës së dorëzuar nga OE Mobelland nuk ishte në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, për faktin se OE nuk e kishte plotësuar aneixin 6 siç është kërkuar në dosje të tenderit e të cilin AK e kishte bashkangjitur si format me dosje. Në listën e kontratave të dorëzuar me ofertë nga OE ankues mungojnë të dhënat të cilat ishin kërkuar nga AK me dosje të tenderit tek anexi 6 dhe atë si; e-mail i blerësit dhe numëri kontaktues i blerësit.

AK, poashtu i kishte njoftuar OE se Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohej nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë të Operatoreve Ekonomik.

Vlerësojmë se në rastin konkret, mugesia e të dhëna si më lartë tek listat e dorëzuara nga grupi i OE ankues sa i përket kontratave të realizuara nuk është në përputhje me kërkesën e dosjes së AK-së, pasi që nuk e kanë plotësuar Aneixin 6 të dosjes siç është kërkuar, mbi këtë bazë vlerësojmë se komisioni i vlerësimit, ka vepruar në përputhje me nenin 59 para. 4 i LPP-së. Andaj mbi këtë bazë vlerësojmë se pretendimi i OE ankues për këtë pikë është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor se OE ankues e ka përmbushur kërkesën e dosjes sa i përket stafit profesional të kërkuar, Eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar në dëshmitë përmes platëformës e-prokurimi, OE ankues me ofertë ka dorëzuar filen e emërtuar “ Parakontrat, diplomat, CV e inxhin”. Në këtë file janë bashkangjitur Cv-në për znj Florijeta Beqiri Bektishi, si inxhinier i arkitekturës, diplomën dhe parakontraten, Cv-në e z. Fahri Beqiri si Dizajner i interierit, diplomën dhe parakontraten. Znj. Florijeta Beqeri Bektishi në Cv-në e saj ka paraqitur gjithësej tre punëdhënës si: Butterfly Kosova- Shtime, pozita agjete e shitjes, data e punësimit korrik 2020 deri në mars 2021, Smira Mermer dhe qeramikë-viti, pozita dizjanere, shitëse, faturiste, punësimi qershor 2021 deri në dhjetor 2022, Doa qeramikë- Ferizaj, pozita Menaxhere, dizajnere, punësimi dhjetor 2022 dhe vazhdon akoma të jete pjese. Vlerësojmë se në rastin konkret, CV-ja e dorëzuar nga OE ankues për znj. Florijeta Beqiri Bektishi, nuk e përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit pasi që e njëjta nuk e ka përvojën e punës prej min 4 viteve siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë, dhe poashtu OE nuk ka prezantuar kontratën por vetëm parakontraten për të lartë cekurën. Bazuar në udhëzimin administrativ nr 001/2023 për prokurim publik, saktësisht në faqen faqen 40 të tij, është rregulluar se si duhet të veprohet në raste kur CV-ja e dorëzuar nuk përmbushë kërkesat e dosjes së tenderit, refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtutjeshme. Si përfundim lidhur me këtë pretendim ankimor, vlerësojmë se dëshmitë e prenatuara nga OE ankues sa i përket stafit nuk e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit dhe se komisioni i vlerësimit ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 59 par 4 i LPP-se kur ka refuzuar ofertën e OE ankues pasi që i njëjti nuk e ka përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj mbi këtë bazë vlerësojmë se pretendimi i OE ankues për këtë pikë është i paqëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin tjetër ankimor se OE ankues e ka përmbushur kërkesën e dosjes sa i përket ISO standartit nr 13485 2016 të kërkuar, Eksperti shqyrtues sqaron se, bazuar në dëshmitë

përmes platëformës e-prokurimi, OE ankues me ofertë ka dorëzuar filen e emërtuar ISO Standarti, ka dorëzuar certifikatën EN-ISO me nr,13485-2016 të lëshuar nga SISTEMA, për liderin e konzerciumit MOBELLAND, në rastin konkret vlerësojmë se certifikata e dorëzuar vetëm nga lideri e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për faktin se AK në kërkesën e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë kishte kërkuar që operatori ekonomik të dorëzojë certifikatat En-ISO dhe nuk e kishte specifikuar se në rast të grupit të OE certifikatat EN-ISO duhet të plotësohen nga të gjithë anëtarët. Andaj mbi këtë bazë vlerësojmë se pretendimi i palës në ankes për këtë pikë është i qëndrueshëm.

Dilema tjetër e ngritur nga OE ankues është se e ka përmbushur edhe kërkesën e dosjes sa i përketë raportit të vlerësimit të riskut.

Vlerësojmë se në rastin konkret, OE ankues me ofertë ka dorëzuar filen e emërtuar “ Siguria dhe shëndeti”, në këtë file ka bashkangjitur edhe raportin e vlerësimit të riskut, i cili ishte bërë për vitin 2021 apo para tri viteve, ndërsa kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë që vlerësimi i riskut të jetë në përputhje me ligjin 04 L-161, e që bazuar në këtë ligj neni 16 paragrafi 1 parasheh që “Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, me qëllim të parandalimit të rrezikut, përfshirë dhe ekspozimin e të punësuarve nga elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës. Andaj mbi këtë bazë vlerësojmë se pretendimi i palës në ankes për këtë pikë është i paqëndrueshëm.

te posedoje mjete, staibilmente, dhe pajisjet makinerike qe jane te domosdoshme per realizimin e projektit (2 automjete pikup te regjistruara), (2 kamion 3.5 Ton te regjisturara). OE ankues për ta përmbushur këtë kërkesë me ofertë ka dorëzuar filen e emërtuar “ Mobelland librezat e automjeteve” brenda këtij file janë ngakuar marrëveshja për marrjen me qira në mes të kompanisë Mobelland shpk dhe z.Ahmet Morina për automjetin Picup me targa 04-522 JR prodhuesi Pegout Tipi A, vlenë të ceket se kjo marrëveshje nuk ishte e noterizuar ashtu siç ishte kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimit për kontratë, por OE kishte bashkangjitur edhe një autorizim nga Noteri me LPR. Nr. 19535/2023 përmes të cilit z. Ahmet Morina, e autorizon kompaninë Mobelland shpk, të cilën e përfaqëson z, Rizah Morina, që automjetin e lartëcekur mund ta regjistroj, qllajmroj, shet-nenshkruaj kontrate mbi shitblerejn e automjetit dhe që mund ta vozit brenda dhe jashtë Kosovës. Në rastin konkret edhe pse autorizimi nuk e posedon numërin e prokurimit, vlerësojmë se e përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit pasi që kompania mobelland shpk përmes përfaqësuesit të saj është e autorizuar që të disponoj lirshëm me automjetin e lartëcekur. Andaj mbi këtë bazë vlerësojmë se pretendimi i palës në ankes për këtë pikë është pjesërisht i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin ankimor se katalogu i dorëzuar nga OE ankues e përmbushë kërkesën e dosjes së tenderit. Eksperti shqyrtues, sqaron se AK në dosje të tenderit kishte aplikuar kërkesën 6; *Kërkesa e dosjes se tenderit numer 6, Autorizimi i prodhuesit ose dilerit te autorizuar dhe Katalogu Broshura e prodhuesit perPoz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 (per keto pozicone lejohet ofertimi me dimensione +-5%).*

Dëshmia për kërkesën 6, Kopja e Autorizimit me të dhënat e tenderit, Kopja e Katalogut Broshurave e prodhuesit për Poz.Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111 (për keto pozicone lejohet ofertimi me dimensione +-5%)

Për ta përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar, filen e emërtuar “Katalogu” për Kuvendin Komunal Prishtinë” të nënshkruar dhe vulosur nga

Mobelland SHPK, si prodhues, duke i vendosur specifikat teknike per për të gjitha pozicionet si me ato te dosjes së tenderit, po ashtu në kuadër të katalogut të nënshkruar dhe vulosur kishte paraqitur, edhe pozicionet për të cilat ishte kërkuar autorizim nga prodhuesi si; guacën per persona me aftësi te kufizuara dhe parketin. Në cilësinë e ekspertit shqyrtues me dt 28.12.2024 kam kërkuar sqarime shtesë nga AK, sa ju përketë numërave rendor të paraqitur në kërkesën e dosjes së tenderit, të cilën OE ankues e kundërshton me arsyetimin se ka mbetur gabim teknik nga dosja e kaluar e cila është anuluar. AK, me dt. 30.12.2024, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se numërat janë rendor janë të bazuar në rreshtin e parë vertikal Excel, ku numeri rendor 91 është për poz. 3.16 apor furnizim me parket, kurse numeri rëndor 109 është për poz. 4.13 apo Furnizimi, Transporti ,Punimi dhe Montimi të guaskës së WC për perosna me aftësi të kufizuara. Vlenë të ceket se këta numera përputhen saktësisht me numerat rendor të paraqitur në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë, dhe poashtu askush nga OE gjatë fazës tenderuese nuk kishte kërkuar sqarime shtesë, andaj mund të vlerësojm se kanë qenë të qartë dhe se OE-të kanë dorëzuar ofertë njëkohësisht edhe OE ankues.

Vlerësojm se në rastin konkret OE ankues nuk ka dorëzuar katalog ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë, pasi që i njëjti vetëm i ka kopjuar specifikat teknike nga përshkrimi i çmimit dhe anash ka vendosur fotografi të ndryshme për secilin pozicion, duke e përshtatur fotografinë me përshkrimin e pozicionit, kurse sa ju përketë pozicioneve për të cilat ishte kërkuar autorizim nga prodhuesi me ekspertizë po i paraqesim vetëm, pozicionin me numër rendor 91 apo poz. 3.16 “furnizim me parket” dhe pozicioni me numër rendor 109 apo poz. 4.13 frunizimi, montimi i wc guacës për persona me aftësi të kufizuara për të cilën ishte kërkuar autorizim nga prodhuesi.

Provë, “katalogu” i dorëzuar nga OE ankues për pozicion numër rendor 91 apo poz. 3.16 “furnizim me parket” dhe poazicioni numër rendor 109 apo poz. 4.13 Furnizimi, Transporti ,Punimi dhe Montimi të guaskës së WC për perosna me aftësi të kufizuara.

Më tej eksperti shqyrtues sqaron se, OE ankues njësoj si tek pozicionet e lartëcekura kishte vepruar për të gjitha pozicioneve për të cilat është kërkuar edhe autorizim nga prodhuesi, duke përshkruar vetëm specifikat teknike si me dosje të tenderit, duke e bashkangjitur edhe një fotografi, pa bashkangjitur autorizim dhe pa treguar prodhuesin. OE ankues filet që e ka emertuar si " katalogu" e kishte vulosur dhe nënshkruar me vulën e Mobelland shpk në fund të faqes.

Në rastin konkret vlerësojmë se "katalogu" i dorëzuar nga OE ankues nuk e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit pasi që katalogu i dorëzuar nuk i përmbanë të dhënat e kërkuara për asnjë nga pozicionet për të cilat është kërkuar autorizim nga prodhuesi. OE gjatë përgatitjes së ankesës mundohet ta arsyetoj faktin se është vet prodhues dhe se posedon edhe kodin për prodhimin e pajisjeve mjeksore, por bazuar në “ katalogun” e dorëzuar askund për këto pozicione në fotografitë e bashkangjitur nga OE ankues, nuk ceket se janë të prodhuara nga Mobelland shpk, për me tepër në cilësinë e ekspertit shqyrtues kam analizuar edhe web faqen e OE ankues përmes linkut <https://www.mobelland.net> dhe askund nuk kam hasur në ndonjë katalog apo pajisje mjeksore, guacë, parket, të prodhuar nga ky OE siç pretendon në ankesë. Andaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë për këtë pikë është i paqëndrueshme.

Lidhur me pretendimin ankimor se edhe OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse nuk ka dorëzuar katalog për të gjitha pozicionet e kërkuara por vetëm për 9 prej tyre,

Eksperti shqyrtues sqaron se, gr. i OE të rekomanduar për kontratë me ofertë kanë dorëzuar Autorizimin nga prodhuesi Ari Medical Tenchnology Co., Ltd, me seli në Kinë përmes të cilit autorizohet lideri i grupit Made -Kos shpk, dhe autorizimin nga prodhuesi Turmed me seli në Turqi, përmes të cilit është autorizuar lideri Made-Kos shpk. Vlenë të ceket fakti, se në dosje të tenderit dhe njoftim për kontratë AK kishte kërkuar autorizim nga prodhuesi për pozicionet Poz.23,24,25,26,86,91,94,103,104,105,107,108,109,110,111, kurse grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka paraqitur pozicionet me numër rendor, 3.12,4.49,4.50,4.51,4.52, 4.55,4.58,4.63. Meqenëse, pretendimi i OE ankues është se kjo kërkesë ka mbete gabim nga tenderi i anuluar në vitin 2023, sepse ka mospërputhje në mes të numërave në mes të kërkesës së dosjes dhe atyre të dorëzuar me ofertë, nga OE i rekomanduar për kontratë. Poashtu marrë parasysh, se asnjë nga OE, nuk kishte kërkuar sqarime shtese, sa i përketë këtij dallimi në mes të pozicioneve të kërkuara tek dosja e tenderit apo kërkesës 6 tek kapaciteti teknik dhe profesional dhe pozicioneve të paraqitura në paramasë dhe parallogari. Për, ta trajtuar këtë pretendim ankimor me dt 28/12/2024, përmes platëformës E-prokurimi kam kërkuar sqarime shtesë nga ana e Autoriteti Kontraktues. AK me dt 30.12.2024 ka kthyer përgjigje përmes të cilës ka sqaruar se numërat rendor janë të bazuar në rreshtin e parë vertikal Excel. Si për shembull poz. 23 i referohet pikës 1.16 në paramasë, poz 24 i referohet pikë 1.17 të paramasës, poz. 91 pikës 3.16 të paramasës poz. 109 pikë 4.13 e kështu më radh. Në rastin konkret grupi i OE të rekomanduar për kontratë kishte dorëzuar katalogun së bashku me autorizimet nga prodhuesit për pozicionet e lartë cekura të cilat vlerësojm se përputhem me sqarimet e dorëzuara nga AK, dhe se përputhen numërat rendor me ato të paramasës dhe parallogarise me kërksat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Poashtu duhet cekur faktin se AK në vendimin e tij kur ka refuzuar kërkesën për ri-shqyrtim si të pabazuar e ka arsyetuar vendimin për secilin pretendimin ankimor, përfshirë edhe këtë pretendim ankimor. Si përfundim, eksperti shqyrtues, po ashtu sqaron se mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të Autoritetit kontraktues, respektivisht ZPP-së që vlerësimi i ofertave, të bëhet në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 dhe me nenin 56 paragrafi 3 i LPP-së dhe nenin 72 paragrafi i LPP-së në atë mënyrë që lejonë trajtim të barabartë më mes të operatorëve ekonomik dhe të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për parën. Andaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë për këtë pikë është i paqëndrueshme.

Lidhur me pretendimin se AK ka shkelur nenin 61 par 6.3 të rregullores për prokurim publik nr. 001/22, për arsye se nuk e ka nxjerr vendimin brenda 3 ditëve, dhe se nuk e ka njoftur OE se do të zgjatet afati për nxjerrjen e vendimit, OE ankues, me dt 09.12.2024 ka paraqitur kërkesën për ri-shqyrtim tek AK, kurse ankesën në OSHP e ka dorëzuar me dt. 16.12.2024, apo një ditë para se AK të ngrit në platëformë vendimin e saj për refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim. Në rastin konkret vlerësojm se OE ankues ka vepruar në përputhje me nenin 61 par 2 i rregullores për prokurim publik nr.001/22 kur ka paraqitur ankesën pranë OSHP-se edhe pse nuk e kishte pranuar vendimin. Kurse AK, poashtu ka nxjerr vendim konform paragrafit 2 të nenit 61 të rregullores duke e publikuar atë në platëforën e-prokurimi, mirëpo duhet cekur fatki se këtë e ka bërë 8 ditë pas pranimit të kërkesës për ri-shqyrtim duhet të luaj rol aktiv që në të ardhme mos të paraqiten situata të tilla, të vonesës në nxjerrjen e vendimit dhe njoftimit të OE-ve lidhur me trajtimin e pretendimeve ankimore dhe veprimeve tjera ligjore të ndërmarra në një aktivitet të prokurimit. Andaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë për këtë pikë është i pjesërisht i qëndrueshme

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërrish të bazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi B58Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar për nevojat e KPSH-së Ri - tender” me numër të prokurimit 616-24-8683-1-1-1.

Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK dhe të vazhdoj tutje me fazën tjetër të këtij aktiviteti të prokurimit, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar "Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës". Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK konform nenit 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 DHE 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - "Mobelland" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: